

"TOURNEO CONNECT" KREJTËSISHTIRI



MËNYRA E THJESHTË PËR TË SHIJUAR NJË "TOURNEO CONNECT" TË RI

1 EKSPLORONI

2 ZGJIDHNI

3 PERSONALIZONI

4 SPECIFIKIMET

"Tourneo Connect Active" (SWB) në ngjyrë metalike trupi "Boundless Blue" (opsion) me disqe aliazhi 18" 5-shkallëshe në ngjyrë "Black" me shkëlqim mekanik(opsion).



1 EKSPLORONI

MERRNI NË DORË FRENAT E JETËS SUAJ

Njihuni me "Torneo Connect" krejtësisht të ri: një shoqërues udhëtimesh plot stil dhe praktik që është projektuar për aventurat e jetës. Pjesa e brendshme e rehatshme ofron kapacitet prej shtatë sediljesh për familjen tuaj, shokët e skuadrës (dhe pajisjet e tyre), si dhe për nevojat e biznesit dhe të tjera. Shtojini kësaj mundësinë e zgjedhjes së opsioneve të gjatësisë, si dhe një gamë veçorish novatore të ndihmës për drejtuesin dhe teknologjitë dixhitale të kabinës, "Torneo Connect" ju jep shumë arsye për të buzëqeshur.

"Torneo Connect Active" (SWB) në ngjyrë metalike trupi "Boundless Blue" (opsion).



1 EKSPLORONI

ME STIL, I LEHTË DHE ARGËTUES

Dizajni krejtësisht i ri i "Tourneo Connect" siguron që ai të duket po kaq i mirë si në rrugët e qytezave dhe qyteteve, ashtu edhe në rrugë të vështira. Veçoritë kryesore që bien në sy dominojnë në të gjithë gamën, duke përfshirë grilën e sipërme me motive hojzash me rrethim në "Satin Chrome", zbukurimet plot stil të rrotave dhe shiritat unikë të trupit të "Active", ndërsa "Sport" dallohet nga shiritat e kofanos, një parakolp dinamik në stil sportiv dhe disqet e aliazhit 17" në "Black". Shinat e çatisë ofrojnë një platformë për aventura me opsionin për të mbajtur biçikleta, ski dhe të tjera.

"Tourneo Connect Sport" (SWB) në ngjyrë metalike trupi "Graphite Grey" (opsion) me disqe rrotash aliazhi 18" 5-shkallëshe në "Black" me shkëlqim mekanik (opsion).

1 EKSPLORONI

ARGËTIMI NË MJEDISËT E JASHTME

Gjetja e vendit tuaj të lumturisë nuk ka qenë asnjëherë më e lehtë. Drejtimi me të gjitha rrotat aktive disponohet për herë të parë në "Tourneo Connect"*; duke ju ofruar një siguri më të madhe në rrugë dhe duke ju ndihmuar të udhëtoni në sipërfaqe sfiduese të lira ose rrëshqitëse. Hapësira fleksible e kabinës ofron shtatë sedilje të vendosura në tre rreshta, me opsionin e palosjes, uljes ose heqjes së rreshtit të dytë dhe të tretë të sediljeve (opsion) për të krijuar një vëllim ngarkese deri në 3,1 m³**.

Hapësirë e bollshme për pajisjet e sportit, pajisjet për kamping e shumë të tjera.



*Modelet e pajisura me motor me naftë 2,0-litërs 122 PS "EcoBlue" dhe kuti marshesh manuale me 6 marshe.

**Ngarkesa dhe kapaciteti i ngarkesës kufizohen nga pesha dhe shpërndarja e peshës. Ngarkesa maksimale varion dhe është në varësi të aksesorëve dhe konfigurimit të automjetit. Shikoni etiketën në pjesën anësore të derës për kapacitetin mbajtës të një automjeti specifik.

"Tourneo Connect Active" (SWB) në ngjyrë metalike trupi "Boundless Blue" me disqe aliazhi 18" 5-shkallëshe në "Black" me shkëlqim mekanik (opsion).



1 EKSPLORONI

JETA NË MAJAT E GISHTAVE

"Tourneo Connect" i ri është po aq intuitiv sa telefoni juaj inteligjent. Por është shumë herë më i këndshëm. Gjithçka që ju duhet e keni në dorë nëpërmjet ekranit me prekje 8,25" (21 cm) (standard), çka e bën më të lehtë zgjedhjen dhe shikimin e destinacioneve. Ndërkohë zgjedhja e muzikës për t'ju përshtatur drejtimit tuaj është po aq e thjeshtë sa kontaktimi i familjarëve dhe miqve, duke përdorur kontrollet shumëfunksionale në timon.

Për ata që kërkojnë më shumë, ofrohet një sistem opsional informacioni dhe argëtimi me ekran me prekje 10" (25 cm)*. Kjo ju lejon të përdorni plotësisht "FordPass Connect", i cili mundëson një gamë veçorish lidhjeje, duke përfshirë përditësimet e drejtpërdrejta të trafikut, itineraret alternative dhe pikat e karburantit në afërsi për t'ju bërë më të lehtë çdo udhëtim.

*Ekranin me prekje 10" është standard në të gjitha modelet në momentin e hedhjes në treg; bëhet opsional për prodhimet nga viti 2022.

"Tourneo Connect Active" (SWB) në ngjyrë metalike trupi "Boundless Blue" (opsion).

1 EKSPLORONI



"Tourneo Connect Active" (SWB) në ngjyrë metalike trupi "Boundless Blue" (opsion) me disqe aliazhi 18" 5-shkallëshe në ngjyrë "Black" me shkëlqim mekanik (opsion).



1 EKSPLORONI

DREJTIM I LEHTË

Rrugë qyteti të ngjeshura. Drejtim me ndalime të shpeshta. "Tourneo Connect" mund t'ju ndihmojë të largoni stresin e trafikut të rënduar falë kontrollit përshtatës të drejtimit me qendëzim në korsin^{*†}. Sistemi ju ndihmon të mbani një distancë të sigurt nga automjeti përpara dhe dikton vazhdimisht vijat e korsive me aftësinë për të korigjuar timonin dhe për ta mbajtur automjetin tuaj brenda korsisë së shënuar.



SIGURI PËR TË GJITHË

Ndihma para përplasjes¹⁾ me diktim të këmbësorëve dhe çiklistëve** monitoron largësinë tuaj nga automjetet e tjera, këmbësorët dhe çiklistët – madje edhe në errësirë, kur objektet kapen nga dritat e fenerëve – dhe mund t'ju sinjalizojë për një përplasje të mundshme. Nëse nuk reagoni në kohë, sistemi do të reagojë me frenim emergjent si dhe me një manovër devijuese, nëse është e nevojshme.

*Veçoritë e ndihmës për shoferin janë funksione shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen e shoferit, gjykimin e tij dhe nevojën për të kontrolluar automjetin. Kjo nuk e zëvendëson drejtimin e sigurt. Shihni manualin e përdoruesit për detaje dhe kufizime.

**Ndihma para përplasjes me diktim të këmbësorëve dhe çiklistëve mund të diktojë këmbësorët, por jo në të gjitha kushtet, dhe nuk zëvendëson drejtimin e sigurt. Shihni manualin e përdoruesit për kufizimet e sistemit.

⁰⁾Përdor sensorë.

¹⁾Veçoria e ndihmës për drejtuesin.

[†]Opsionale duke filluar nga vera e vitit 2022.

1 EKSPLORONI

QETËSI MENDORE

"Tourneo Connect" i ri ju ndihmon të shmangni aksidentet, si dhe goditjet e mërzitshme dhe gërvishtjet. Sistemi i informimit për pikat e vdekura të shikimit¹⁾ përdor drita të integruara në të dyja pasqyrat e dyerve për t'ju paralajmëruar kur një automjet futet në pikën tuaj të vdekur të shikimit gjatë drejtimit. Po ashtu, sinjalizuesi për trafikun në kryqëzim²⁾ ju paralajmëron për automjete në lëvizje ose rreziqe të tjera, si p.sh. kalimtarë, mure dhe shtylla kur dilni mbrapsht nga një hapësirë pingule parkimi.



NJË MIRËPRITJE E NGROHTË

Pak gjëra në jetë mund të jenë aq të besueshme sa një "Tourneo Connect" – veçanërisht moti. Për këtë arsye automjeti juaj disponohet me sedilje opsionale me ngrohje, të cilat përdoren lehtësisht nëpërmjet ekranit me prekje 10" (25 cm) të montuar në kruskot (standard); gjithashtu, mund të zgjidhni një timon me ngrohje (opcion). Rehati ideale për të eksploruar në dimër, për t'u kthyer nga aktivitetet sportive ujore apo edhe pas një dite pune në mjedis të jashtëm.

²⁾Përdor sensorë.

¹⁾Veçoria e ndihmës për drejtuesin.

1 EKSPLORONI

THJESHTËSI


Artikuj më të mëdhenj rimorkimi me siguri, falë paketës së ndihmës për rimorkimin me "Pro Trailer Backup Assist"* të re (opsion). Sistemi zvogëlon rrezikun e palosjes kur dilni mbrapsht me një rimorkio dhe ju lejon të kontrolloni rimorkion me më shumë lehtësi, duke përdorur dorezën e rregullimit të pasqyrës së derës – një vegël ideale për drejtuesit e të gjitha niveleve të përvojës.



GJITHMONË GATI

Falë karikimit me valë (opsion) për telefonat inteligjentë të përputhshëm me "Qi" (teknologjia e karikimit me induksion), nuk keni pse përdorni më një kablo për të qëndruar të lidhur. I shpejtë dhe i lehtë për t'u përdorur, kompleti i karikimit me valë mundëson karikimin e një game pajisjesh ndërsa jeni në lëvizje. Një platformë karikimi kundër rrëshqitjes siguron qëndrimin e pajisjes suaj saktësisht aty ku duhet, pavarësisht se sa i vështirë është terreni.

*Veçoritë e ndihmës për shoferin janë funksione shitesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen e shoferit, gjykimin e tij dhe nevojën për të kontrolluar automjetin. Kjo nuk e zëvendëson drejtimin e sigurt. Shihni manualin e përdoruesit për detaje dhe kufizime.



1 EKSPLORONI

GJITHMONË TË INFORMUAR

Njohja e shenjave të qarkullimit^{†(1)} ndihmon që ju dhe personat rreth jush të jenë të sigurt. Sistemi shfaq informacione të rëndësishme të shenjave të qarkullimit në panelin e instrumenteve, për t'ju ndihmuar që të qëndroni të informuar për shpejtësitë e ndryshueshme në rrugë dhe autostradë, si dhe për kufizimet.

[†]Opsion në të gjitha seritë.
¹Përdor sensorë. ¹⁾Veçoria e ndihmës për drejtuesin.



REHATI MAKSIMALE

Çdo udhëtim duhet të jetë i rehatshëm. Me sediljet ergonomike të akredituara nga "Aktion Gesunder Rücken" (AGR) (fushata për shpina më të shëndetshme) që ofrojnë mbështetëse mesi me rregullim elektrik në katër pozicione, mund të shijoni ndjesinë e çlodhjes dhe rehatisë në destinacionin tuaj.



PARKIM I PËRSOSUR

Si pjesë e paketës së parkimit, ndihma aktive e parkimit me ndihmën për daljen nga parkimi⁰¹ mund të identifikojë dhe t'ju drejtojë automatikisht për të hyrë dhe dalë nga hapësirat pingule të parkimit ndërsa ju kontrolloni gazin, frenat dhe përzgjedhjen e marsheve. Është kaq e lehtë.

⁰Përdor sensorë. ¹⁾Veçoria e ndihmës për drejtuesin.




1 EKSPLORONI

GJITHMONË I FOKUSUAR

Sistemi për qëndrim në korsi¹⁾ dikton nëse jeni duke dalë në mënyrë të paqëllimshme nga korsia. Paralajmërimet jepen në mënyrë vizuale dhe nëpërmjet dridhjes së timonit. Nëse nuk reagoni, ndihma për qëndrim në korsi²⁾ do t'ju vijë në ndihmë për t'ju mbajtur brenda korsisë së shënuar.

⁰Përdor sensorë. ¹⁾Veçoria e ndihmës për drejtuesin.



TEKNOLOGJIA E VËMENDJES


Nëse për ndonjë arsye ju humbisni aftësitë tuaja, sistemi i ndihmës për gjendjen e drejtuesit* reagon ndaj mungesës së aktivitetit nga ana juaj duke lëshuar një tingull paralajmërues dhe dridhje dhe nëse është e nevojshme kryen një manovër të sigurt frenimi.

*Veçoritë e ndihmës për shoferin janë funksione shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen e shoferit, gjykimin e tij dhe nevojën për të kontrolluar automjetin. Kjo nuk e zëvendëson drejtimin e sigurt. Shihni manualin e përdoruesit për detaje dhe kufizime.



EXPERT I SIGURISË

Nëse përfshiheni ndonjëherë në ndonjë përplasje të lehtë apo të rëndë, sistemi i frenimit pas përplasjes mund të optimizojë sigurinë tuaj duke reduktuar shpejtësinë, çka ndihmon në parandalimin dhe reduktimin e ndikimit të një përplasjeje të dytë të mundshme.



I SHPEJTË DHE PRAKTIK

Ecni drejt "Tourneo Connect" tuaj dhe sistemi pa çelësa i "Ford" dallon praninë e çelësit elektronik dhe shkyç dyert. Kur hyni brenda, nuk ka nevojë për një çelës ndezjeje, thjesht shtypni pedalin e friksionit, shtypni butonin e ndezjes "Ford Power" dhe jeni gati për të vazhduar. (Opsion)

2 ZGJIDHNI

Gama krejtësisht e re "Ford Tourneo Connect" është e disponueshme në një sërë dizajnesh të veçanta dhe plot stil. Zbuloni se cila i përshtatet nevojave të stilit tuaj të jetesës dhe shijeve tuaja personale.

PAMJE E PËRGJITHSHME E SERIEVE



"Tourneo Connect" ofron prakticitet dhe rehati. Me opsionin e 7 sediljeve, si dhe me hapësirën e bollshme për bagazhet dhe kafshët shtëpiake, është shoqëruesi ideal për aventurat e jetës.



"Grand Tourneo Connect" ju mundëson të rehatoheni edhe më shumë pasi është 353 mm më e gjatë, me një hapësirë më të madhe për bagazhet dhe dyer më të gjera me rrëshqitje për më shumë prakticitet.



TITANIUM

Karakteristikat e jashtme kryesore

- Xham i pasmë i errësuar
- Grilë e sipërme në ngjyrë "Black" me rrethim në "Satin Chrome"
- Parakolp me detaje në "Chrome"
- Pasqyra dyersh elektrike, me ngrohje dhe palosje automatike kur kyçni makinën me kapakë pasqyrash me shkëlqim në ngjyrë "Black"
- Fshirëse të përparme me sensorë shiu
- Shina çatie në ngjyrë "Silver"
- Disqe aliazhi 16" 10-shkallëshe në ngjyrë "Silver"

- Doreza të jashtme të derës së pasme dhe të dyerve anësore në ngjyrën e trupit

Karakteristikat e brendshme kryesore

- Konsolë qendrore cilësore me 2 mbajtëse gotash dhe mbështetëse të rregullueshme krahu, ajrosje të pasme dhe 2 porta të pasme USB.
- Sedilje të përparme me ngrohje
- Pasqyrë për shikim pas me errësim automatik
- Levë marshi me zbukurime lëkure
- Butoni i ndezjes
- Tabaka në rreshtin e dytë të sediljeve

Motorët

Benzinë

1,5 L Ford EcoBoost 114 PS (84 kW) me 6 marshe manuale

Naftë

2,0 L Ford EcoBlue 122 PS (90 kW) me 6 marshe manuale

2,0L Ford EcoBlue 122 PS (90 kW) me 7 marshe automatike



ACTIVE

Karakteristikat e jashtme kryesore shtesë të "Titanium"

- Grilë e sipërme me motive hojzash në ngjyrë "Black" me rrethim në "Satin Chrome"
- Parakolp dhe prapakolp me pllaka mbrojtëse në ngjyrë "Silver"
- Disqe aliazhi 17" 5-shkallëshe në "Black" me shkëlqim mekanik
- Shinë dere me rrëshqitje në "Black"
- Stema "Active"
- Shirita "Black" në harqet e rrotave dhe në parakolp dhe prapakolp

Karakteristikat e brendshme kryesore shtesë të "Titanium"

- Zbukurime unike të sediljeve "Active" me tegela "Blue"
- Mbajtëse koshi mbeturinash në derën e pasagjerit

Motorët

Naftë

- 2,0 L Ford EcoBlue 122 PS (90 kW) me 6 marshe manuale
- 2,0L Ford EcoBlue 122 PS (90 kW) me 7 marshe automatike



SPORT

Karakteristikat e jashtme kryesore shtesë të "Titanium"

- Shina çatie "Black"
- Parakolp në stil sportiv
- Disqe aliazhi 17" 5-shkallëshe në "Black"
- Fenerë plotësisht LED
- Drita të pasme LED
- Çatia, mbulesa, parakolpi dhe prapakolpi dhe dera e pasme në "Matt Black" dhe shirita dekorues "Silver" në "Sport"
- Dizajn metalik i pedaleve

Karakteristikat e brendshme kryesore shtesë të "Titanium"


- Pllaka anësore të dyerve të përparme
- Panel zbukurimi i dyerve me detaje "Clip"/"Soul" dhe mbështetëse krahu
- Zbukurime unike të sediljeve të "Sport" me tegela "Red"
- Grup dixhital 10" i konfigurueshëm

Motorët

Naftë

2,0L Ford EcoBlue 122 PS (90 kW) me 7 marshe automatike

SERITË



3 PERSONALIZONI

"Tourneo Connect" krejtësisht i ri ju mundëson të jeni krijues, me mundësinë e zgjedhjes së ngjyrave klasike dhe të forta.



Boundless Blue
Ngjyrë metalike trupi*

NGJYRAT



Comet Grey
Ngjyrë e njëjtë trupi



Dusky Silver
Ngjyrë metalike trupi*



Maple Red
Ngjyrë metalike trupi*



Frozen White
Ngjyrë e njëjtë trupi



Graphite Grey
Ngjyrë metalike trupi*



Midnight Blue
Ngjyrë metalike trupi*



Lava Red
Ngjyrë e njëjtë trupi



Intense Black
Ngjyrë metalike trupi*



Stardust Silver
Ngjyrë metalike trupi*


*Me çmim shtesë.

"Ford Tourneo Connect" mbulohet nga garancia kundër gërryerjes e "Ford" për 12 vjet nga data e regjistrimit të tij të parë. Në varësi të kushteve të përgjithshme.

Vini re Figurat e përdorura të makinave shërbejnë vetëm për të ilustruar ngjyrat e trupit dhe mund të mos reflektojnë specifikimet aktuale ose disponueshmërinë e produktit në disa tregje. Ngjyrat dhe zbulimet që tregohen në këtë broshurë mund të ndryshojnë nga ngjyrat konkrete për shkak të kufizimeve në procesin e përdorur të printimit.

3 PERSONALIZONI

ZBUKURIMET



"Bubble/Ford Kylo Emboss" në "Soul"/"Clip"
në "Soul" (me tegela "Grey")
Standard në "Titanium"



"Glacier on City" në "Soul"/"Clip" në "Soul"
(me tegela "Blue")
Standard në "Active"



"Ford Transition Emboss" në "Soul"/"Vinyl" në
"Soul" (me tegela "Red")
Standard në "Sport"



"Ford Diamond Design 004" në "Soul"/"Vinyl"
në "Soul"
Opsion në "Titanium"

3 PERSONALIZONI

DISQET



16"

Disqe aliazhi 10-shkallëshe në ngjyrë "Silver"
Standard në "Titanium"



17"

Disqe aliazhi 10-shkallëshe "Brilliant Silver"
Opsion në "Titanium"



17"

Disqe aliazhi 5-shkallëshe në "Black" me
shkëlqim mekanik
Standard në "Active"



17"

Disqe aliazhi 5-shkallëshe në "Black"
Standard në "Sport"



18"

Disqe aliazhi 5-shkallëshe në "Black" me
shkëlqim mekanik
Opsion në "Active" dhe "Sport"

4

SPECIFIKIMET

Zbuloni shumë prej veçorive kryesore që ofron "Tourneo Connect" krejtësisht i ri, duke përfshirë teknologjinë efikase të motorit dhe nivelet e bollshme të pajisjeve.

Ne të gjithë kemi përgjegjësinë të zbusim ndikimin tonë në mjedis kur udhëtojmë dhe motori me naftë 2,0-litërs "Ford EcoBlue" me efikasitet karburanti ju ndihmon të bëni pikërisht këtë gjë. Sistemi i reduktimit katalitik selektiv përdor AdBlue® për të shndërruar në azot dhe ujë emetimet e NO_x në gazin e shkarkuar, ndërsa filtri i grimcave të naftës është i projektuar për të kapur 99% të grimcave të ngurta të shkarkuara nga skrapamentoja e automjetit*. Është një veçori inteligjente.

I disponueshëm me 122 PS (90 kW), kostoja e ulët e përdorimit* pajtohet me standardet e rrepta "Euro" për emetimet, ndërsa ofron performancë të mjaftueshme dhe fuqi tërheqëse.

*Për informacione të mëtejshme dhe për informacione rreth emetimeve, referojuni seksionit të specifikimeve.

FUQIA

Diesel

AdBlue® / DEF

ISO 22241-1

AdBlue® / DEF

4 SPECIFIKIMET

	Ford EcoBoost 1,5 L	Ford EcoBoost 1,5 L	Ford EcoBlue 2,0 L	Ford EcoBlue 2,0 L	Ford EcoBlue 2,0 L	Ford EcoBlue 2,0 L	Ford EcoBlue 2,0 L	Ford EcoBlue 2,0 L
Konfigurimi i sediljeve	5 sedilje	7 sedilje	5 sedilje	7 sedilje	5 sedilje	7 sedilje	5 sedilje	7 sedilje
Standardi i emetimeve	Faza M1 6,2	Faza M1 6,2	Faza M1 6,2	Faza M1 6,2	Faza M1 6,2	Faza M1 6,2	Faza M1 6,2	Faza M1 6,2
Fuqia maksimale PS (kW)	114 (84)	114 (84)	122 (90)	122 (90)	122 (90)	122 (90)	122 (90)	122 (90)
Forca rrotulluese Nm	220	220	320	320	320	320	320	320
Transmisioni	Me 6 marshe manuale	Me 6 marshe manuale	Me 6 marshe manuale	Me 6 marshe manuale	Me 6 marshe manuale	Me 6 marshe manuale	Me 7 marshe automatike	Me 7 marshe automatike
Drejtimi	FWD	FWD	FWD	FWD	AWD	AWD	FWD	FWD
TOURNEO								
Emetimet e CO ₂ ⁰⁰ (g/km) – WLTP i përgjithshëm	146-150	146-150	128-130	128-130	140-144	140-144	136-140	136-140
Konsumi i karburantit ⁰⁰ në L/100 km – WLTP i përgjithshëm	6,4-6,6	6,4-6,6	4,9-5,0	4,9-5,0	5,4-5,5	5,4-5,5	5,2-5,3	5,2-5,3
PERFORMANCA⁰								
Shpejtësia maksimale (km/orë)	181	181	187	187	175	175	186	186
0-100 km/orë (sekonda)	11.9	11.9	11.1	11.1	12.1	12.1	11.4	11.4
PESHAT DHE NGARKESAT								
Pesha neto (kg)*	1542	1557	1610	1629	1712	1731	1643	1655
Pesha bruto e automjetit (kg)	2150	2300	2220	2350	2300	2450	2250	2400
Pesha maks. e rimorkios 12% (kg)	1400	1300	1500	1400	1500	1400	1500	1400
Pesha maksimale që tërhiqet (kg) (pa frena)	750	750	750	750	750	750	750	750
Kufiri i ngarkesës vertikale (kg) (ngarkesa në kapjen e rimorkios)	75	75	75	75	75	75	75	75

*Kapaciteti i bagazheve dhe i ngarkesës kufizohet nga pesha dhe shpërndarja e peshës.

KARBURANTI DHE PERFORMANCA

TOURNEO

	Ford EcoBoost 1,5 L	Ford EcoBoost 1,5 L	Ford EcoBlue 2,0 L	Ford EcoBlue 2,0 L	Ford EcoBlue 2,0 L	Ford EcoBlue 2,0 L	Ford EcoBlue 2,0 L	Ford EcoBlue 2,0 L
GRAND TOURNEO								
Emetimet e CO ₂ ⁰⁰ (g/km) – WLTP i përgjithshëm	147-152	147-152	130-133	130-133	142-146	142-146	137-142	137-142
Konsumi i karburantit ⁰⁰ në L/100 km – WLTP i përgjithshëm	6,5-6,7	6,5-6,7	5,0-5,1	5,0-5,1	5,4-5,6	5,4-5,6	5,3-5,4	5,3-5,4
PERFORMANCA⁰								
Shpejtësia maksimale (km/orë)	181	181	për t'u deklaruar	për t'u deklaruar	175	175	186	186
0-100 km/orë (sekonda)	12.4	12.4	për t'u deklaruar	për t'u deklaruar	12.5	12.5	11.8	11.8
PESHAT DHE NGARKESAT								
Pesha neto (kg)*	1608	1627	1682	1695	1781	1797	1709	1721
Pesha bruto e automjetit (kg)	2220	2350	2300	2450	2350	2500	2300	2450
Pesha maks. e rimorkios 12% (kg)	1400	1300	1500	1500	1500	1500	1500	1500
Pesha maksimale që tërhiqet (kg) (pa frena)	750	750	750	750	750	750	750	750
Kufiri i ngarkesës vertikale (kg) (ngarkesa në kapjen e rimorkios)	75	75	75	75	75	75	75	75

⁰Shifra të testeve të "Ford".

⁰⁰Konsumet e deklaruara të karburantit/energjisë WLTP, emetimet e CO₂ dhe diapazonet elektrike përcaktohen në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të rregullore evropiane (KE) 715/2007 dhe (BE) 2017/1151 të ndryshuara së fundmi. Procedurat standarde të zbatuara të testimit mundësojnë krahasimin ndërmjet llojeve të ndryshme të automjeteve dhe prodhuesve të ndryshëm.

Përveç efikasitetit të karburantit/energjisë të makinës, në përcaktimin e konsumit të karburantit/energjisë së makinës, në emetimet e CO₂ dhe në diapazonin e energjisë luajnë rol mënyra e drejtimit dhe faktorë të tjerë joteknikë. CO₂ është gaz i kryesor me efekt serrë përgjegjës për ngrohjen globale. Udhëzuesi për kursimin e karburantit dhe emetimet e CO₂ që përmban të dhëna për të gjitha modelet e reja të automjeteve për pasagjerë disponohet falas në çdo pikë shitjeje.

*Paraqet peshën më të lehtë neto duke supozuar një shofer me peshë 75 kg, nivele plot të lëngjeve dhe nivele karburanti 90%, në varësi të tolerancave të prodhimit dhe opsioneve etj. me të cilat është pajisur. Kufijtë e rimorkimit të cituar këtu paraqesin aftësinë maksimale të rimorkimit të automjetit në masën e tij bruto të automjetit për t'u rinisur në pjerrësi 12 për qind mbi nivelin e detit. Performanca dhe kursimi tek të gjitha modelet ulen kur automjetet përdoren për rimorkim. Masa bruto e mjetit me rimorkio përfshin peshën e rimorkios.

4 SPECIFIKIMET

DIMENSIONET (MM)

	Tourneo Connect	Tourneo Connect (7 sedilje)	Grand Tourneo Connect	Grand Tourneo Connect (7 sedilje)
Gjatësia e përgjithshme	4515	4515	4868	4868
Gjerësia e përgjithshme me pasqyra/me pasqyra të palosura/pa pasqyra	2100/1931/1855	2100/1931/1855	2100/1931/1855	2100/1931/1855
Lartësia e përgjithshme (pa ngarkesë)	1833	1833	1836	1836
Gjerësia e hyrjes së derës anësore	666	666	797	797
Gjerësia e hapësirës së ngarkesës ndërmjet harqeve të rrotave	1185	1185	1185	1185
Gjerësia e hyrjes së ngarkesës në dyshemenë	1185	1185	1185	1185
Lartësia e ngarkesës	1200	1200	1211	1211
Gjatësia e hapësirës së ngarkesës në variantin me 2 sedilje	1913	1913	2265	2265
Gjatësia e hapësirës së ngarkesës në variantin me 5 sedilje	1100	1100	1452	1452
Gjatësia e hapësirës së ngarkesës në variantin me 7 sedilje	–	316	–	629
Rrethi i kthesës (m)	11.4	11.4	12.1	12.1
KAPACITETI I BAGAZHIT (LITRA)				
Kapaciteti i ngarkesës në variantin me 2 sedilje (litra)	2556	2556	3105	3105
Kapaciteti i ngarkesës në variantin me 5 sedilje (litra)	1213	1213	1720	1720
Kapaciteti i ngarkesës në variantin me 7 sedilje (litra)	–	248	–	650
KAPACITETI I SERBATORIT TË KARBURANTIT (LITRA)				
Benzinë	50	50	50	50
Naftë	50	50	50	50
AdBlue®	15	15	15	15

Të gjitha dimensionet (të shfaqura në mm) u nënshtrohen tolerancave të prodhimit, u referohen modeleve me specifikime minimale dhe nuk përfshijnë pajisjet shtesë. Këto ilustrime shërbejnë vetëm për orientim. Dimensionet mund të ndryshojnë në varësi të modelit dhe të pajisjeve të montuara.

DIMENSIONET



GRAND TOURNEO



	Ngjyra të njëjta trupi			Ngjyra metalike trupi*						
	Comet Grey	Frozen White	Lava Red	Boundless Blue	Dusky Silver	Graphite Grey	Intense Black	Maple Red	Midnight Blue	Stardust Silver
TITANIUM										
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljeve: Bubble/Ford Kylo Emboss në Soul	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: Clip në Soul	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ngjyra e panelit të instrumenteve lart dhe poshtë: Soul/Grain	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljeve: Ford Diamond Design 004 në Soul	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: Vinil në Soul	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ngjyra e panelit të instrumenteve lart dhe poshtë: Soul/Grain	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
AKTIVE										
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljeve: Glacier on City in Soul	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: Clip në Soul	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ngjyra e panelit të instrumenteve lart dhe poshtë: Soul/Grain	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
SPORT										
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljeve: Ford Transition Emboss në Clip në Soul	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: Vinil në Soul	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ngjyra e panelit të instrumenteve lart dhe poshtë: Soul/Grain	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

*Boja metalike është një opsjon me çmim shtesë.



REZERVONI DREJTIM PROVË SOT

Mënyra më e mirë për të zbuluar gamën emocionuese të "Tourneo Connect" është duke qenë në timon.

Rezervoni një drejtim provë sot dhe shitësi lokal i "Ford" do të ketë kënaqësinë t'ju ndihmojë sa më shpejt të jetë e mundur.



Figurat, përshkrimet dhe specifikimet. Kjo broshurë ka qenë e saktë në kohën e printimit. Megjithatë, politika e Ford-it synon drejt zhvillimit të vazhdueshëm të produktit. E drejta i rezervohet ndryshimit të specifikimeve, ngjyrave dhe çmimeve të modeleve dhe artikujve të ilustruar dhe të përshkruar në çfarëdo kohe në këtë botim. Për të dhënat më të fundit, këshillohuni gjithmonë me shitësin e Ford-it. **Pajisje fakultative.** Kudo në këtë botim, sa herë që një karakteristikë përshkruhet si një "Opsion" ose "Pajisje/Paketë Fakultative", etj., ju duhet të supozoni se ajo do të jetë me çmim shtesë kundrejt modelit bazë, përveçse kur deklarohet ndryshe. Të gjithë modelet dhe kombinimet e ngjyrave varen nga disponueshmëria. Shënim. Disa nga figurat janë të një modeli para prodhimit dhe/ose të krijuara me kompjuter, prandaj konstruksioni/funksionet në versionin final të automjetit mund të jenë të tjera në raste të ndryshme. Gjithashtu, disa nga karakteristikat e treguara në automjete mund të jenë fakultative. Shënim. Kjo broshurë përmban si aksesore origjinale të Ford-it, ashtu dhe një gamë produktesh nga furnizuesit tanë. Vendosja e aksesoreve shtesë, mund të ketë ndikim në konsumin e karburantit të automjetit tuaj. +Aksesoret e identifikuar janë aksesore markash të zgjedhura me kujdes nga furnizues të palës së tretë, të cilat nuk mbulohen nga garancia e Ford-it, por nga garancia e vetë furnizuesit të palës së tretë, të dhënat e të cilit mund t'i merrni te shitësi juaj i Ford-it. Marka e fjalës iPod dhe logot janë pronë e Apple Inc. Markat dhe emrat e tjerë tregtarë janë ato të pronarëve të tyre përkatës. Shënim. Disa veçori ndihmëse dhe sigurie për drejtuesin e mjetit të përshkruara në këtë broshurë janë projektuar të funksionojnë duke përdorur sensorë, performanca e të cilëve mund të ndikohet nën kushte të caktuara të motit ose të mjedisit.

Katalogu Botimi Ndërkombëtar është vetëm për informacion të përgjithshëm; specifikimet e bëra nuk kanë lidhje me ndonjë treg të veçantë. Ka mundësi që ilustrimet ose teksti të përmbajnë referenca për modelet, karakteristikat ose kushtet, të cilat nuk janë të disponueshme në disa vende, as si pajisje standardë, as si fakultative. Për më tepër, ato mund të lënë jashtë karakteristika të veçanta që janë të disponueshme. Kështu që, ju lutemi konsultohuni gjithmonë me Shitësin e Ford-it për detajet më të fundit të specifikimeve dhe çmimet aktuale.

Botuar nga "Ford Motor Company Limited", Laindon, Essex, Angli. Regjistruar në Angli me nr. 235446. © Ford Motor Company Limited.